



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË  
SË SHTETIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP)** në mbështetje të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të nenit 17, pika “ç” bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.

**Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPP)** në mbështetje të ligjit Nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit“ neni 46, bashkëpunon me institucionet e tjera qendrore të administratës publike, të rregulluara me akte normative të përbashkëta.

Përsa më sipër, palët bien dakort të respektojnë qëllimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi si më poshtë:

#### **Neni 1 Qëllimi**

- Realizimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.
- Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për hetimin administrativ të funksionarëve të administratës publike që mbartin detyrim për deklarim të interesave private në bazë të ligjit nr.9049, dt.10.4.2003 dhe ligjit nr.9367, dt.7.4.2005.

## **Neni 2 Objekti**

- Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.
- DPP angazhohet që të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive çdo informacion apo të dhënë që disponon ky institucion, që lidhen me kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës së interesave private të zyrtarëve-subjekte të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
- ILDKP nga ana e saj angazhohet të vërë në dispozicion të DPP çdo informacion apo të dhënë, të dalë nga verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të interesave private të zyrtarëve-deklarues, që i shërben veprimtarisë institucionale të DPP.
- DPP angazhohet që të mbështesë në terren grupet e investigimit të ILDKP duke i bashkëshoqëruar me punonjës të strukturave të saj, të cilët do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit të mbledhjes së informacioneve.

## **Neni 3 Komunikimi**

Palët do të caktojnë person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandunit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 4 Ndryshime**

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.

## **Neni 5 Përfundimi i Memorandunit**

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.

Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara dates së përfundimit të tij.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe dy të tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 13 Mars 2008.

**PËR INSPEKTORATIN E LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT  
TË PASURIVE**

**PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË POLICISË SË SHITETIT**

**INSPEKTOR I PERGJITHSHEM  
FATMIRA LASKA**

**DREJTOR I PERGJITHSHEM  
AHMET PRENÇI**